



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo za Odbrane / Ministry Of Defense



RAPORT VJETOR 2025

Prishtinë, 2026

PËRMBAJTA

QËLLIMET STRATEGJIKE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR PERIUDHËN 2021-2025	3
HYRJE	4
QËNDRUESHMËRIA KOMBËTARE, SFIDAT DHE RRUGA PËRPARA	5
BASHKËPUNIMI I RI MES KOSOVËS E SHBA-SË PËR FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË	6
MARRËVESHJE E RËNDËSISHME PËR BASHKËPUNIM NË INDUSTRINË E MBROJTJES MES KOSOVËS DHE BELGJIKËS.....	8
ANGAZHIMI SHUMËPALËSH DHE INICIATIVAT RAJONALE	9
AVANCIMI I DIPLOMACISË SË MBROJTJES DHE INTEGRIMIT EUROATLANTIK	9
KOSOVA ZGJERON PËRFAQËSIMIN NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN E MBROJTJES	11
MARRËVESHJE DHE BASHKËPUNIME STRATEGJIKE TË MINISTRISË SË MBROJTJES GJATË VITIT 2025	13
VITI 2025 - HAP VENDIMTAR PËR MODERNIZIMIN DHE FUQIZIMIN E KAPACITETEVE USHTARAKE TË FSK-SË	14
FORCIMI I KAPACITETEVE MBROJTËSE	16
SHBA-JA FURNIZON FSK-NË ME AUTOBLINDA	17
FSK-JA DËSHMON PROFESIONALIZËM DHE INTEROPERABILITET NË "DEFENDER EUROPE 25"	18
FSK-JA SHËNON RITJE, ARRIN NË 4450 USHTARË AKTIVË	19
BUXHETI 2026: MBI 216 MILIONË EURO PËR MINISTRINË E MBROJTJES DHE RITJE E VAZHDUESHME FINANCIARE	20
ZGJERIMI I INFRASTRUKTURËS SË FSK-SË	20
AKTIVITETET PËR AVANCIM STRATEGJIK NGA DREJTORIA PËR POLITIKA TË MBROJTJES	21
MINISTRIA E MBROJTJES DHE FSK-JA INTENSIFIKOJNË BASHKËPUNIMIN CIVILO-USHTARAK	22
AVANCIMI I KUADRIT LIGJOR DHE MBËSHTETJA JURIDIKE	23
RREZULTATET DHE AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË PROKURIMIT	23
MBËSHTETJE LOGJISTIKE DHE ADMINISTRATIVE PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË FSK-SË	24
DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE VLERSIM KOORDINON HARTIMIN E PLANIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2025	25
SIGURIA KIBERNETIKE DHE TRAJNIMET SPECIALISTIKE PËR MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS DIGJITALE	25
FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET VENDORE TË SHENDETËSISË PËRMES DHURIMIT VULLNETAR TË GJAKUT	26
RRITJA E TRANSPARENCËS DHE ANGAZHIMIT ME PUBLIKUN	26
KOORDINIMI PROTOKOLLAR DHE ORGANIZIMI I NGJARJEVE ZYRTARE NË VITIN 2025.....	27
MENAXHIM EFIKAS I DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR.....	27
AVANCIMI I BARAZISË GJINORE NË MINISTRINË E MBROJTJES DHE FSK	28
ANGAZHIMI I NJËSISË PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE JOSHUMICË NË FSK.....	29
MBI 1.1 MILIONË METRA KATRORË SIPËRFAQE TË PASTRUAR NGA MINAT GJATË VITIT 2025	30

QËLLIMET STRATEGJIKE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR PERUDHËN 2021–2025



- Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile, rritja e llogaridhënies dhe transparencës;
- Zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial;
- Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në operacione jashtë vendit;
- Mbajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve thelbësore për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile.

HYRJE

Viti 2025 shënoi një etapë të rëndësishme në zhvillimin dhe forcimin e sektorit të mbrojtjes në Republikën e Kosovës.

Gjatë këtij viti, Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës kanë vazhduar interesimin për të ndërtuar kapacitetet moderne mbrojtëse duke u bazuar në prioritetet strategjike të vendit dhe standardet e aleatëve ndërkombëtarë. Investimet për modernizimin e pajisjeve ushtarake, zhvillimi i kapaciteteve profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët strategjikë kanë rritur gatishmërinë operacionale dhe ndërveprueshmërinë e FSK-së.

Në të njëjtën kohë, vëmendje e veçantë iu kushtua forcimit të reziliencës kombëtare dhe zhvillimit të partneriteteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Bashkëpunimi i ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, si dhe iniciativat për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes kontribuuan për të avancuar më tej kapacitetet institucionale dhe operacionale të vendit.

Në raportin vjetor janë paraqitur zhvillimet kryesore gjatë vitit 2025 në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Në vijim paraqiten disa nga iniciativat dhe aktivitetet kryesore që kanë shënuar këtë periudhë në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe zhvillimin e sektorit të mbrojtjes në Republikën e Kosovës



QËNDRUESHMËRIA KOMBËTARE, SFIDAT DHE RRUGA PËRPARA

Gjatë vitit 2025, Ministria e Mbrojtjes është angazhuar vazhdimisht që të forcojë qëndrueshmërinë (reziliencës) kombëtare, e cila është vendosur si prioritet kryesor strategjik. Meqë u vendos si prioritet strategjik, u organizua Konferenca “Rezilienca kombëtare – sfidat dhe rruga përpara”, në bashkëpunim me NALT (NATO Advisory Liaison Team), ku u diskutuan sfidat moderne të sigurisë dhe masat për t’i adresuar ato.

Politika për qëndrueshmëri përfshin zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe ndërveprueshmërinë ndërinstitucionale, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe investimet në infrastrukturën kritike, me qëllim që Forca e Sigurisë së Kosovës dhe institucionet shtetërore të rrisin gatishmërinë për t’i përballuar sfidat e ndryshme, përfshirë fatkeqësitë natyrore, kërcënimet kibernetike dhe sfidat rajonale.



Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, në kuadër të planit politik, qëndrueshmërinë kombëtare e ka vendosur si prioritet strategjik, duke e konsideruar jo vetëm si një masë mbrojtjeje, por një domosdoshmëri për ruajtjen e funksioneve jetike të shoqërisë dhe për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit të vendit.



BASHKËPUNIMI I RI MES KOSOVËS E SHBA-SË PËR FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË



Pasi u vendos rezilienca kombëtare si prioritet strategjik, një tjetër hap kyç për forcimin e sektorit të mbrojtjes ka qenë avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në mbledhjen e 251-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës u miratua në parim nisma për arritjen e një marrëveshjeje ndërshtetërore kornizë në fushën e mbrojtjes. Kjo iniciativë, e hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, është në përputhje me objektivat strategjike të Kosovës për bashkëpunim të ngushtë me shtetet aleate që të avancojë bashkëpunimin dypalësh në fusha kyçe të mbrojtjes, duke përfshirë planifikimin e mbrojtjes, qëndrueshmërinë strategjike dhe ngritjen e kapaciteteve ushtarake.



Në vijim, në qershor të vitit 2025, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, vizituan Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u takuan me zëvendësin e Sekretarit për NATO dhe Evropë, David Baker dhe delegacionin e tij në Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-së. Temë kryesore e takimit ishte bashkëpunimi dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, përfshirë diskutimin mbi përmbylljen e fazës së tretë të Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe zhvillimin e industrisë së mbrojtjes përmes projekteve të përbashkëta. Vizita e konfirmoi partneritetin e fortë strategjik mes Kosovës dhe SHBA-së dhe nënvizoi angazhimin e përbashkët për rritjen e ndërveprueshmërisë së FSK-së dhe stabilitetit rajonal.



MARRËVESHJE E RËNDËSISHME PËR BASHKËPUNIM NË INDUSTRIJË DHE MBROJTJES MES KOSOVËS DHE BELGJIKËS

Gjatë Panairit Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes (IDEF) në Stamboll, në korrik të vitit 2025, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka takuar ministrin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Belgjikës, Theo Francken. Në këtë takim, u nënshkrua Deklarata e Qëllimit mes dy ministrive, e cila konsiderohet si hap i rëndësishëm që kontribuon për thellimin e marrëdhënieve bilaterale në fushën e mbrojtjes.

Marrëveshja do të mundësojë bashkëpunimin për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes, përmirësimin e shkëmbimeve teknologjike dhe forcimin e lidhjeve ushtarake për të përballuar sfidat e përbashkëta në fushën e sigurisë. Ky bashkëpunim do të kontribuojë në avancimin e kapaciteteve të FSK-së dhe do të forcojë lidhjet mes dy vendeve në nivelin e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare.



ANGAZHIMI SHUMËPALËSH DHE INICIATIVAT RAJONALE

Në mars të vitit 2025, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, së bashku me homologun shqiptar dhe homologun kroat nënshkruan një deklaratë trepalëshe për bashkëpunim në mbrojtje dhe siguri. Marrëveshja synon forcimin e lidhjeve ndërmjet tri vendeve, rritjen e ndërveprueshmërisë ushtarake përmes trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta, si dhe koordinimin për integritet euroatlantike dhe përballimin e kërcënimeve hibride.

Në kuadër të angazhimit shumëpalësh dhe iniciativës rajonale, Republika e Kosovës ka vazhduar pjesëmarrjen në mekanizmin A5 si vëzhguese dhe në Grupin e Kontaktit për Ukrainën, duke ndihmuar në shkëmbimin e përvojave, koordinimin e veprimeve dhe forcimin e bashkëpunimit me aleatët.



AVANCIMI I DIPLOMACISË SË MBROJTJES DHE INTEGRIMIT EUROATLANTIK

Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike (DBNIEA) ka vazhduar të forcojë diplomacinë e mbrojtjes dhe integritetin euroatlantik të Republikës së Kosovës. Ky angazhim ka përfshirë zgjerimin e bashkëpunimit bilateral dhe shumëpalësh, si dhe avancimin e pozitës ndërkombëtare të vendit, në përputhje me objektivat strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë vitit janë përgatitur dhe nënshkruar planet bilaterale me Gjermaninë, Turqinë dhe Italinë, ndërsa planet me shtetet e tjera janë në proces përfundimi. Procesi i nënshkrimit të Marrëveshjeve SOFA me Jordaninë dhe Gjermaninë do të vazhdojë, ndërsa DBNIEA ka organizuar edhe Dialogun Bilateral të Mbrojtjes (BDC) me SHBA-në.



RAPORT VJETOR

FSK-ja ka dislokuar kontingjente në Mbretërinë e Bashkuar për Operacionin “Interflex” dhe në Belize, duke theksuar pjesëmarrjen ndërkombëtare dhe gatishmërinë për operacione të përbashkëta.



KOSOVA ZGJERON PËRFAQËSIMIN NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN E MBROJTJES

Republika e Kosovës ka shënuar një sërë zhvillimesh të rëndësishme për forcimin e përfaqësimit të saj ndërkombëtar në sektorin e mbrojtjes, duke zgjeruar rrjetin e atasheve ushtarakë dhe duke thelluar bashkëpunimin me partnerët strategjikë.

Një hap me peshë të veçantë ishte vendimi i Belgjikës për të njohur zyrtarisht atasheun e mbrojtjes të Republikës së Kosovës në Bruksel. Njohja zyrtare e atasheut fuqizon përfaqësimin ushtarak të Kosovës në zemër të institucioneve euroatlantike dhe përbën një hap domethënës në rrugën e integritimit.

Po ashtu, nënkolonel Meriman Suka u akreditua si atashe ushtarak me të drejta të plota i Republikës së Kosovës në Turqi, duke forcuar më tej bashkëpunimin me një nga partnerët kyç në fushën e mbrojtjes. Përveç kësaj, ai është emëruar edhe atashe jorezident në Mbretërinë Hashemite të Jordanisë. Me të vizituar kryeqytetin e Jordanisë (Ammani), atasheu zhvilloi takime me zyrtarë të lartë të Forcave të Armatosura të Jordanisë, ku u diskutua për zgjerimin e bashkëpunimit, shkëmbime stërvitore dhe programe të specializuara trajnimi.



Në Evropë, Kosova ka zgjeruar praninë e saj përmes kolonel Bekim Zejnullahut, i cili mori detyrën si i Ngarkuar i Mbrojtjes në Gjermani. Gjatë mandatit të tij, ai ka zhvilluar takime në Ministrinë e Mbrojtjes gjermane dhe në Bundeswehr, duke riafirmuar partneritetin strategjik mes dy vendeve. Nga Berlioni ai do të angazhohet edhe në Slloveni si atashe jorezident, duke forcuar më tej marrëdhëniet bilaterale.

Kolonel Zejnullahu është akredituar gjithashtu si atasheu i parë jorezident i mbrojtjes i Kosovës në Republikën e Çekisë. Gjatë vizitës në Pragë, i shoqëruar nga ambasadorja e Kosovës, ai realizoi takime të nivelit të lartë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura çeke dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, duke hapur perspektiva të reja për bashkëpunim.

Në Azi, kolonel Beton Retkoceri u akreditua si i Ngarkuar i Mbrojtjes në Japoni, ku zhvilloi vizitat e para zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes në Japoni. Ky hap shënon një zgjerim të rëndësishëm të pranisë së Kosovës në rajonin aziatik dhe thellim të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Këto zhvillime dëshmojnë një strategji të qartë të Kosovës për të konsoliduar praninë e saj institucionale në arenën ndërkombëtare, për të forcuar partneritetet strategjike dhe për të avancuar integrimin euroatlantik përmes diplomacisë së mbrojtjes.



MARRËVESHJE DHE BASHKËPUNIME STRATEGJIKE TË MINISTRISË SË MBROJTJES GJATË VITIT 2025

Ministria e Mbrojtjes ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume mirëkuptimi me institucione publike, universitete, organizata shoqërore dhe partnerë të tjerë strategjikë.

Në nëntor të vitit 2025, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Gafurr Dugolli, nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, prof. dr. Isak Shabanin, e cila marrëveshje synon rritjen e bashkëpunimit në zhvillimin e programeve studimore të përbashkëta, avancimin e kërkimit shkencor dhe forcimin e kapaciteteve vendore në fushën e sigurisë kibernetike dhe teknologjisë së informacionit.

Këto bashkëpunime përfaqësojnë një angazhim të thellë të Ministrisë së Mbrojtjes për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, duke kontribuar në zhvillimin e sigurisë kombëtare dhe forcimin e kapaciteteve përballë sfidave të sigurisë globale.



VITI 2025 – HAP VENDIMTAR PËR MODERNIZIMIN DHE FUQIZIMIN E KAPACITETEVE USHTARAKE TË FSK-SË

Forca e Sigurisë së Kosovës ka shënuar rritje profesionale dhe modernizim të kapaciteteve të saj ushtarake, duke forcuar ndjeshëm gatishmërinë operacionale dhe duke u përafruar me standardet më të avancuara të mbrojtjes bashkëkohore. Investimet në pajisje moderne, zgjerimi i kapaciteteve ajrore dhe avancimi i trajnimeve profesionale kanë qenë në fokus të zhvillimit strategjik të FSK-së.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme ishte mbështetja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ngritjen e kapaciteteve ajrore të FSK-së. Në vitin 2025, SHBA-ja miratoi blerjen e helikopterëve, radarëve dhe sistemeve të mbrojtjes ajrore për Kosovën, duke i dhënë mbështetje një projekti që e pozicionon vendin në një nivel më të lartë të sigurisë dhe gatishmërisë strategjike.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi të ngushtë me partnerin strategjik amerikan, Ministria e Mbrojtjes pranoi edhe sistemin e fluturakeve pa pilot AeroVironment RQ-20 Puma, të siguruar përmes programit Foreign Military Sales (FMS). Këto pajisje moderne do të shërbejnë për forcimin e aftësive të FSK-së në fushën e inteligjencës, vëzhgimit dhe operacioneve ajrore pa pilot. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, e cilësoi këtë si një hap të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të zbulimit dhe si dëshmi të bashkëpunimit të shkëlqyer me SHBA-në.



Modernizimi nuk është ndalur me kaq. FSK-ja u pajis edhe me mijëra dronë luftarakë kamikazë “Skydagger”, të prokuruar nga kompania turke “Baykar”. Dhjetëra pjesëtarë të FSK-së tashmë janë trajnuar për përdorimin e tyre. Këta dronë të tipit RTF (Ready to Fly), të pajisur me mjete shpërthyesë për goditjen e objektivave lëvizëse dhe statike, përfaqësojnë një rritje të ndjeshme të fuqisë goditëse të ushtrisë.

Me integrimin e dronëve “Skydagger”, krahas sistemit TB2 Bayraktar dhe fluturakeve “Puma”, FSK-ja po ndërton një kapacitet të avancuar të operacioneve ajrore pa pilot, në përputhje me zhvillimet më të reja teknologjike dhe taktikat e luftës moderne. Pajisjet e reja u transportuan me kamionët multifunksionalë Rheinmetall (8x8), të siguruar vitin e kaluar, duke dëshmuar një qasje të qëndrueshme dhe të planifikuar drejt ndërtimit të një force moderne, profesionale dhe plotësisht funksionale.



FORCIMI I KAPACITETEVE MBROJTËSE

Në Ministrinë e Mbrojtjes është nënshkruar kontrata kornizë me kompaninë amerikane AM General, një nga prodhuesit më të njohur të industrisë së mbrojtjes. Kjo kontratë përfshin furnizimin me sisteme moderne të artilerisë mobile **HUMVEE Hawkeye 105mm Mobile Howitzer (MHS)**.

Në kuadër të kontratës përfshihen gjithashtu automjete moderne mbështetëse, pjesë rezervë, shërbime të mirëmbajtjes, si dhe trajnime të specializuara për operimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve.

Me këtë investim, Forca e Sigurisë së Kosovës hyn në një fazë të re të zhvillimit, duke rritur ndjeshëm kapacitetet e fuqisë së zjarrit për qitje direkte në distanca të gjata.

Kjo marrëveshje përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe në ndërtimin e një ushtrie moderne, profesionale, të gatshme dhe të ndërveprueshme me aleatët strategjikë, duke kontribuar në rritjen e sigurisë kombëtare dhe stabilitetin afatgjatë rajonal.



SHBA-JA FURNIZON FSK-NË ME AUTOBLINDA

Në vitin 2025, Forca e Sigurisë së Kosovës ka pranuar një donacion të rëndësishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kështu që FSK-së iu shtuan edhe disa autobllinda amerikane. Ceremonia solemne e pranimit-dorëzimit të këtyre mjeteve u zhvillua me pjesëmarrjen e kryeministrit Albin Kurti, ministrit të Mbrojtjes Ejup Maqedonci, atashut të ushtrisë në Ambasadën e SHBA-së, nënkolonel Jonathan Shaw, dhe komandantit të FSK-së, gjenerallejtnant Bashkim Jashari.

Ky donacion përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në avancimin e kapaciteteve operacionale të FSK-së, duke i siguruar asaj mjete dhe teknologji të nevojshme për realizimin e misionit të saj kushtetues. Mbështetja e vazhdueshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbetet dëshmi e partneritetit strategjik dhe e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet dy vendeve.

Autoblindat do të kontribuojnë për të rritur gatishmërinë dhe mobilitetin e njësive të FSK-së, si dhe në avancimin e mëtejshëm të kapaciteteve të saj në përputhje me standardet e aleancës së NATO-s.



FSK-JA DËSHMON PROFESIONALIZËM DHE INTEROPERABILITET NË “DEFENDER EUROPE 25”

Forca e Sigurisë së Kosovës demonstroi ushtrimet duke treguar nivel të lartë angazhimi dhe profesionalizmi gjatë pjesëmarrjes së saj në ushtrimin shumëkombësh “Defender Europe 25”. Demonstrimi rikonfirmoi pozicionin kyç të FSK-së për promovimin e sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal. Në kuadër të këtij ushtrimi, Kosova organizoi me sukses Ditën e Vizitorëve të Shquar, ku priti personalitete të larta kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe kontribuoi në disa shtete partnere përmes njësive të dërguara jashtë vendit.

Ngjarja qendrore në Republikën e Kosovës filloi në Aeroportin e Gjakovës, ku Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralëjtënant Bashkim Jashari, priti mysafirë të rangut të lartë, përfshirë zyrtarë të qeverisë, diplomatë dhe liderë ushtarakë ndërkombëtarë. Ata vizituan Pikën e Komandës Taktike të Divizionit të 28-të të Këmbësores të Ushtrisë së SHBA-së, ku u paraqitën zhvillimet lidhur me ushtrimin në Ballkanin Perëndimor, së bashku me bashkëpunimin ndërkombëtar mes forcave të dislokuara në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Bullgari, Mal të Zi, Greqi dhe në Kosovë.



FSK-JA SHËNON RITJE, ARRIN NË 4450 USHTARË AKTIVË

Forca e Sigurisë së Kosovës ka shënuar rritje të konsiderueshme të kapaciteteve njerëzore, duke vazhduar konsolidimin e saj si forcë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe e përgatitur sipas standardeve bashkëkohore ushtarake. Në muajin mars, në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, u betuan 344 ushtarë të rinj, ndërsa në qershor të vitit 2025 këtij kontingjenti iu shtuan edhe 350 rekrutë të tjerë. Me këto dy gjenerata, FSK-së iu bashkuan gjithsej 694 ushtarë të rinj gjatë vitit 2025, prej të cilëve 635 meshkuj dhe 59 femra. Ceremonitë e betimit u zhvilluan në praninë e udhëheqësve më të lartë shtetërorë dhe ushtarakë, duke nënvizuar rëndësinë strategjike të investimit në kapitalin njerëzor.



Për të përforcuar strukturën e saj operative, FSK-ja ka arritur një nivel prej 4 450 (katër mijë e katërqind e pesëdhjetë) ushtarë aktivë, duke ruajtur kështu një kapacitet të qëndrueshëm dhe të balancuar të forcave. Paralelisht me rekrutimin e përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka zbatuar politika aktive për gjithëpërfshirje, duke hapur në tremujorin e katërt konkursin për pranimin e 60 ushtarëve aktivë nga radhët e komuniteteve joshumicë. Pas procesit të selektimit dhe testeve, janë përzgjedhur 45 kandidatë (43 meshkuj dhe 2 femra), duke forcuar përfaqësimin dhe diversitetin brenda strukturës së FSK-së. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe zhvillimit të kuadrit për oficerë. Gjatë vitit 2025 janë rekrutuar 53 kadetë për arsimim ushtarak brenda dhe jashtë vendit, përfshirë 19 prej tyre në Qendrën e Studimeve Universitare (QSU), 19 në Shqipëri, 6 në Gjermani, 4 në Turqi, 3 në Mbretërinë e Bashkuar dhe 2 në Kroaci. Kjo shpërndarje ndërkombëtare e arsimit kontribuon drejtpërdrejt në ngritjen e standardeve profesionale dhe ndërveprueshmërisë me partnerët aleatë. Përmes këtyre zhvillimeve, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, kanë dëshmuar përkushtim të vazhdueshëm në ndërtimin e një force të re, të trajnuar dhe të motivuar, duke e vendosur burimin njerëzor në qendër të transformimit dhe modernizimit të ushtrisë së Kosovës.

BUXHETI 2026: MBI 216 MILIONË EURO PËR MINISTRINË E MBROJTJES DHE RITJE E VAZHDUESHME FINANCIARE




Sipas ndarjeve buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2025, buxheti i aprovuar për Ministrinë e Mbrojtjes ishte mbi 207 milionë euro, i ndarë në kategori ekonomike, si: paga, shtesa dhe kompensime, mallra, shërbime, shpenzime komunale dhe investime kapitale. Departamenti për Menaxhimin e Financave, bazuar në objektivat institucionale, ka realizuar përgatitjen e planeve buxhetore, rishikimet dhe ndryshimet buxhetore, mbajtjen e evidencës së shpenzimeve dhe të hyrave, raportimin financiar, menaxhimin e pasurisë jofinanciare, si dhe sigurimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me fushëveprimin e tij. Gjatë vitit 2025 janë pranuar donacione në valutën euro në vlerë totale mbi 12 milionë euro. Ndërsa, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes sipas Ligjit të Buxhetit Nr.10/L-001 për vitin 2026, është mbi 216 milionë euro.

ZGJERIMI I INFRASTRUKTURËS SË FSK-SË

Një hap i rëndësishëm për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës u realizua me pranimin zyrtar të një lokacioni të ri nga pronat e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës. Pranim–dorëzimi u krye në bashkëpunim dhe koordinim mes dy komisioneve përkatëse, duke siguruar një proces transparent dhe efikas.

Lokacioni, me sipërfaqe prej 100 hektarësh, ndodhet në rajonin e Batllavës (ish-poligoni i Batllavës), në komunën e Podujevës, te vendi i quajtur “Lumi i Surdullit”. Ky zhvillim pasqyron përpjekjet e pandërprera për të përmirësuar dhe zgjeruar kapacitetet operacionale dhe infrastrukturën e FSK-së.

Në mbledhjen e 247-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 31 janar 2025, u miratua vendimi për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Këto prona janë të evidentuara si pronë shoqërore – Ndërmarrja e Pyjeve. Ky hap pason procesin e transformimit dhe forcimit të kapaciteteve të FSK-së, duke përfshirë edhe marrjen e ish-poligonit të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës për Zonën e 5-të Mbrojtëse të ZOLL-it. Transferimi i këtyre pronave synon të përmirësojë infrastrukturën dhe kapacitetet operacionale të Forcave të Sigurisë së vendit, duke kontribuar në konsolidimin e kapaciteteve ushtarake dhe sigurimin e një të ardhmeje më të sigurt për Republikën e Kosovës.



AKTIVITETET PËR AVANCIM STRATEGJIK NGA DREJTORIA PËR POLITIKA TË MBROJTJES

Në vitin 2025, Departamenti për Politika dhe Strategji ka vazhduar angazhimin në zhvillimin dhe zbatimin e dokumenteve kyçe strategjike, në funksion të zhvillimit dhe avancimit të kapaciteteve të mbrojtjes. Gjatë këtij viti, ka vazhduar monitorimi i zbatimi i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës (SSK) dhe Strategjisë së Mbrojtjes (SM) duke u angazhuar edhe në hartimin e dokumenteve planifikuese strategjike që janë derivate të këtyre dokumenteve. Pra, është hartuar Plani Afatmesëm për periudhën 2026–2028 si dhe janë hartuar politikat afatmesme dhe objektivat zhvillimore për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitet 2026–2028. Po ashtu, bazuar në politikat e mbrojtjes afatgjate dhe dokumentet strategjike të lartcekura (SSK dhe SM), ka filluar hartimi i Planit Afatgjatë Zhvillimor i Mbrojtjes (PAZH) për periudhën 2026–2036.

Një aktivitet i rëndësishëm që u zhvillua në shtator të vitit 2025 është punëtorja për Reziliencë/Qëndrueshmërinë Kombëtare, organizuar në Ministrinë e Mbrojtjes, në bashkëpunim me NALT-in dhe partnerë të tjerë strategjikë. Ky aktivitet ishte një vazhdim i konferencës "Qëndrueshmëria Kombëtare", mbajtur më herët gjatë pjesës së parë të vitit, dhe kishte për qëllim avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për zbatimin e këtij koncepti e cila gjithashtu do t'i paraprijë në të ardhmen hartimit të një politike/strategjie për Qëndrueshmëri Kombëtare. Me këtë rast u diskutua për harmonizimin e infrastrukturës ligjore ndërinstitucionale dhe krijimin e Ekipit Punues për hartimin e Strategjisë së Qëndrueshmërisë Kombëtare, një hap kyç për forcimin e kapaciteteve të Kosovës për përballimin e sfidave dhe krizave, si dhe për avancimin e sigurisë kolektive në nivel kombëtar dhe rajonal. Ky aktivitet, si pjesë e një serie iniciativash të Departamentit për Politika dhe Strategji, tregon angazhimin e vazhdueshëm për zhvillimin e politikave të mbrojtjes dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, për të garantuar një reagim të shpejtë dhe të efektshëm ndaj çdo sfide që mund të paraqitet në të ardhmen.



MINISTRIA E MBROJTJES DHE FSK-JA INTENSIFIKOJNË BASHKËPUNIMIN CIVILO-USHTARAK

Sektori për Bashkëpunim Civilo–Ushtarak ka koordinuar një numër të madh kërkesash dhe aktivitete, duke përfshirë vizita të shumta nga institucione arsimore dhe organizata të tjera në kazemat e FSK-së. Në shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, FSK-në e vizituan 5364 nxënës, ndërsa për Ditën e Forcës morën pjesë 2978 nxënës. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm ishte koordinimi dhe pjesëmarrja e FSK-së në ceremoni të varrimit të veteranëve të UÇK-së dhe ngjarje të tjera përkujtimore, si dhe mbështetje për 14-të aktivitete për institucione të ndryshme. Pjesë e këtij bashkëpunimi ishin: mbështetja për turne dhe gara ndërkombëtare si "Tour of Kosovo", maratona ndërkombëtare, ligjërata për nxënës në shkollat e Kosovës si dhe mbështetje mjekësore në aktivitete sportive dhe shoqërore.



AVANCIMI I KUADRIT LIGJOR DHE MBËSHTETJA JURIDIKE

Viti 2025 ka shënuar avancime të dukshme në forcimin e kuadrit ligjor të Ministrisë dhe FSK-së. Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mbrojtjes ka realizuar një sërë aktivitete për mbështetje ligjore dhe zbatimin e legjislacionit. Kjo ka përfshirë monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, përfaqësimin dhe mbrojtjen gjyqësore të MM-së dhe FSK-së, si dhe ofrimin e opinioneve ligjore dhe përgatitjen e propozim-vendimeve.



REZULTATET DHE AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË PROKURIMIT

Viti 2025 ka sjellë përparim në menaxhimin e proceseve të prokurimit publik në Ministrinë e Mbrojtjes. Gjatë vitit 2025, Departamenti i Prokurimit dhe Kontratave në Ministrinë e Mbrojtjes ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitete prokurimi, duke ndjekur Planin Përfundimtar të Prokurimit Publik (PPP) dhe Planin e Veçantë të Prokurimit (PVP). Aktivitetet kanë përfshirë furnizime, shërbime dhe ndërtime, me një avancim të dukshëm krahasuar me vitet e kaluara, si në aspektin e volumit të punës, ashtu edhe në respektimin e procedurave dhe legjislacionit të prokurimit publik.



MBËSHTETJE LOGJISTIKE DHE ADMINISTRATIVE PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË FSK-SË

Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë ka ofruar mbështetje të vazhdueshme logjistike dhe administrative për zhvillimin e kapaciteteve të FSK-së dhe përfaqësimin e saj dinjitoz në arenën ndërkombëtare. Departamenti ka bashkërenduar vazhdimisht aktivitetet me Divizionin për Siguri të Aviacionit Civil në MPB për furnizime përmes Aeroportit të Prishtinës, duke mundur pranimin e drejtpërdrejtë të ngarkesave dhe dërgimin e pajisjeve në misionet jashtë vendit.

Kjo mbështetje ka përfshirë pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, si: "Combined Resolve" në Gjermani, "Winter Exercise 2025" në Turqi, stërvitje në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe aktivitete të tjera të rëndësishme.

DLI-ja ka menaxhuar procesin e donacioneve, duke u koordinuar me donatorët. Donacioni më i madh ka ardhur nga Gjermania, në vlerë rreth 7.6 milionë euro me pajisjet që mund të përdoren gjatë procesit të kërkim-shpëtimit. Pastaj, donacionet nga SHBA-ja që kapin vlerën rreth 5.27 milionë dollarë dhe 45 mijë euro pajisje për komunikim, pajisje për EOD, laborator i gjuhës angleze etj., si dhe donacione nga Ministria e Shëndetësisë dhe Turqia, që kanë kontribuar në avancimin e kapaciteteve operacionale dhe mbështetëse të FSK-së.



DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE VLERËSIM KOORDINON HARTIMIN E PLANIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2025

Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim (DPV) pati një rol kyç në koordinimin e hartimit të planeve të Ministrisë së Mbrojtjes, duke garantuar përputhshmërinë e tyre me objektivat strategjike të institucionit dhe politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Që t'i mbështesë objektivat strategjike vjetore të ministrit të Mbrojtjes për vitin 2025, DPV-ja ka koordinuar përgatitjen e Planit Vjetor të Ministrisë së Mbrojtjes. Ky dokument është hartuar në përputhje me Programin Qeveritar 2021–2025 dhe është përfshirë në Planin e Punës së Qeverisë.

Po ashtu, Departamenti ka zhvilluar procesin e vlerësimit të progresit të Ministrisë së Mbrojtjes përmes analizave dhe raportimeve periodike mbi nivelin e realizimit të objektivave institucionale. Vlerësimi është kryer në baza tremujore, me theks të veçantë në zbatimin e aktiviteteve të parapara në Planin Vjetor të Punës (PVP) dhe në Planin Kombëtar për Zhvillim (PKZH) të Qeverisë.

SIGURIA KIBERNETIKE DHE TRAJNIMET SPECIALISTIKE PËR MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS DIGJITALE

Në kuadër të avancimit të sigurisë kibernetike, gjatë vitit janë zhvilluar ushtrime dhe takime të rëndësishme, përfshirë ushtrimin TTX në kuadër të GPSKIK, bashkëpunimin me DCAF për hartimin e procedurave teknike (Playbooks) si dhe mbajtjen e takimit të 15-të të Grupit Punues Ndërinstitucional. Në këtë takim është trajtuar funksionalizimi i mekanizmit për Zbulimin e Koordinuar të Cenueshmërive në sistemet e TI-së.

Paralelisht, janë realizuar aktivitete për ngritjen e vetëdijesimit mbi rreziqet dhe kërcënimet kibernetike. Është nënshkruar marrëveshje ndërmjet MM-së dhe FSK-së dhe RIT KOSOVA për ofrimin e trajnimeve specialistike në TI, Siguri Kibernetike, AR/GIS, GIS PMI dhe standarde ISO, ku pjesëtarët kanë ndjekur 20 lloje trajnimesh të ndryshme.

Po ashtu, përfaqësues të institucionit kanë marrë pjesë në Samitin për Veprim mbi Inteligjencën Artificiale në Paris, në “Prague Cybersecurity Conference” në Pragë, si dhe kanë realizuar vizitë studimore në Agjencinë e Sigurisë Kibernetike të Republikës së Çekisë, për të shkëmbyer përvoja dhe për të thelluar bashkëpunimin ndërkombëtar.



FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET VENDORE TË SHËNDETËSISË PËRMES DHURIMIT VULLNETAR TË GJAKUT

Përmes organizimit të aksioneve për dhurimin vullnetar të gjakut në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës ka vazhduar bashkëpunimi i përvitshëm me institucionet vendore të shëndetësisë, në veçanti me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

Në janar të vitit të kaluar, kontingjenti i FSK-së me kapacitete mjekësore ROL 1 iu bashkua vendeve partnere të NATO-s në Ushtrimin Fushor "KFOR 36", i cili u realizua në JMRC Hohenfels, Gjermani. Gjatë këtij ushtrimi, FSK-ja ofroi mbështetje reale mjekësore për të gjitha ushtritë pjesëmarrëse, duke u koordinuar ngushtësisht me shërbimin mjekësor të Ushtrisë Amerikane.



RRITJA E TRANSPARENCËS DHE ANGAZHIMIT ME PUBLIKUN

Gjatë vitit, Zyra për Marrëdhënie me Publikun ka zgjeruar komunikimin me qytetarët përmes platformave digjitale, duke ofruar informim të saktë dhe transparent për aktivitetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Janë publikuar njoftime dhe komunikata zyrtare, si dhe është monitoruar reagimi i publikut për të siguruar komunikim të hapur dhe profesional.

ZMP-ja ka menaxhuar përmbajtjet në rrjetet sociale dhe në ueb-faqen zyrtare, ka përkthyer materiale në gjuhën serbe dhe ka monitoruar mediat vendore e rajonale, duke kontribuar në rritjen e besimit dhe bashkëpunimit me publikun.




KOORDINIMI PROTOKOLLAR DHE ORGANIZIMI I NGJARJEVE ZYRTARE NË VITIN 2025

Njësia e Protokollit ka mbështetur organizimin e aktiviteteve zyrtare, përfshirë shënimin e ngjarjeve shtetërore, pritjen e homologëve dhe koordinimin e vizitave brenda dhe jashtë vendit. Janë organizuar ceremoni zyrtare, përfshirë nënshkrime marrëveshjesh, diplomime dhe pensionime, si dhe është ofruar mbështetje protokollare për udhëheqjen e MM-së dhe FSK-së.



MENAXHIM EFIKAS I DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Departamenti për Menaxhimin e Dokumenteve dhe Arkivit gjatë këtij viti ka realizuar aktivitetet me efikasitet të plotë, aktivitetet kryesore të planifikuara për vitin 2025 dhe aktivitetet e tjera sipas kërkesave. Sektori për Administrimin e Dokumenteve në Librin Kryesor të Protokollit ka trajtuar **6785** dokumente të ndryshme. Zyra për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar në Librin e Protokollit për informata të klasifikuara ka trajtuar **695** dokumente. Gjithsej në total janë trajtuar **7480** dokumente.



AVANCIMI I BARAZISË GJINORE NË MINISTRINË E MBROJTJES DHE FSK

Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës kanë bërë hapa të rëndësishëm në avancimin e barazisë gjinore. Pjesëmarrja e grave në strukturat e Ministrisë dhe FSK-së është rritur, me një fokus të veçantë në rekrutimin e të rejave dhe përfshirjen e grave në pozita udhëheqëse. Ministria ka zhvilluar fushata informuese për të inkurajuar të rejtat që t'i bashkohen ushtrisë dhe të ndihmojnë në promovimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet.

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Ministria e Mbrojtjes ka uruar gratë e FSK-së dhe zyrtaret e Ministrisë, duke theksuar rolin e tyre të rëndësishëm në forcimin e sigurisë dhe në avancimin e barazisë shoqërore. Po ashtu, është angazhuar për të siguruar mundësi profesionale të barabarta për secilën grua dhe për të garantuar trajtim të barabartë në çdo aspekt të karrierës ushtarake.

Në përputhje me angazhimin për barazi, Ministria e Mbrojtjes ka shpallur objektivin e ngritjes së numrit të femrave në FSK në 1000 pjesëtare gjatë katërvjeçarit të ardhshëm dhe vazhdon të mbështesë avancimin akademik dhe profesional të femrave në ushtri.



ANGAZHIMI I NJËSISË PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE JOSHUMICË NË FSK

Njësia për Çështje të Komuniteteve e Ministrisë së Mbrojtjes, ka përmbushur angazhimet e saj për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve joshumicë, e cila ofron udhëzime strategjike për integrimin e qëndrueshëm të këtyre grupeve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në kuadër të aktiviteteve të rekrutimit, NJÇK-ja ka organizuar takime me përfaqësues institucionalë, organizata joqeveritare dhe komuna ku jetojnë komunitetet joshumicë, me qëllim që të rritë ndërgjegjësimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional për integrimin e qëndrueshëm të këtyre komuniteteve në FSK.



Plani i Deminimit i vitit 2025 është hartuar sipas prioriteteve të rrezikut të lartë dhe sigurisë publike, në koordinim me FSK-në, NPA-n dhe HALO Trustin. Pas sezonit, të dhënat janë përditësuar në IMSMA dhe është kaluar në IMSMA CORE për monitorim dhe planifikim më efikas.

Janë realizuar 367 inspektime nga Sigurimi i Kualitetit i QKD-së, duke mbikëqyrur operacionet sipas standardeve IMAS, përfshirë kontrollin e pajisjeve, procedurave (SOP) dhe shënjëzimin e zonave të rrezikshme, me fokus sigurinë e civilëve.







Publikuar nga:
Drejtoria për Politika të Mbrojtjes
Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim
Zyra për Marrëdhënie me Publikun